



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ERZEN

Nr. Serial 000045

LEJE
PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR

Nr. 9/10 Prot., datë 18/5/2026

Miratuar me:
VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT LUMOR ERZEN

Nr.7, datë 04/05/2026

Emri i individit/subjektit:	“GEGA OIL GROUP” SH.A
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT):	K76911001E
Baseni Lumor:	ERZEN
Kodi i Trupit Ujor:	-
Qarku:	DURRËS
Bashkia/ Njësia administrative:	DURRËS/PORTO ROMANO
Koordinatat:	X=451942.312 Y=4583383.663 Z=1 m
Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji:	Qëllime të ndryshme (Sanitar, MNZ)
Prurja ekologjike	-
Sasia e ujit që jepet për përdorim	Q_{log}= 0.6 l/s
Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka)	NUK KA
Vendi ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer	NUK KA
Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura:	K.U.Z
Sipërfaqja e tokës, me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes)	NUK KA (ha)
Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka)	SIPAS KUSHTEVE TË LEJES
Periudha e vlefshmërisë	5 VJET
Hyrja në fuqi	Pas publikimit në regjistrin kombëtar të licensave dhe lejeve

KRYETARI

SHKËLQIM HAJDARI



Kushtet e posaçme të lejes për përdorim burimi ujqor nëntokësor

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë dhe mirëmbajë me shpenzimet e veta pajisjet për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organi përkatës që ka lëshuar lejen;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer, në një regjistër të posaçëm dhe të raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Në rastin e shfrytëzimit të burimit ujqor për hidroenergji, të instalojë një stacion hidrometrologjik, për matjen e prurjeve ditore, në një distancë jo më shumë se 150 m poshtë çdo veprë marrjeje dhe të dhënat t'i raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
7. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujqore;
8. Leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër, pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujqore;
9. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes;
10. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
11. Të lejojë rrjedhën ekologjike, sipas specifikimeve në leje;
12. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujqor në rast të një aksidenti, apo incidenti;
13. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujqor në gjendjen e mëparshme;
14. Të mos cënojë faunën dhe florën ujqore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
15. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit ujqor nga subjekte të tjerë për sasinë e papërdorur;
16. Të zbatojë parimet dhe kushtet e tjera për veprimtarinë, të përcaktuara në ligjin për burimet ujqore.